

NJOFTIM PËR ZHVILLIMIN E
ASAMBLESË SË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË
WVP FUND MANAGEMENT TIRANA SH.A

Të nderuar aksionarë,

Me anë të këtij njoftimi dëshiroj t'ju bëj me dije se në datë **28 Prill 2022 ora 16:00** në lidhje me skype, do të zhvillohet Mbledhja e Asamblesë së aksionarëve të shoqërisë WVP Fund Management Tirana SH.A.

Në rend të ditës së mbledhjes së asamblesë së aksionarëve janë për diskutim dhe vendimarrje çështjet e mëposhtme:

1. Miratimi i pasqyrave financiare të audituara për vitin 2021 për Shoqërinë WVP Fund Management Tirana
2. Miratimi i pasqyrave financiare të audituara të Fondit "WVP Top Invest" për vitin 2021
3. Miratimi i pasqyrave financiare të audituara të Fondit "WVP Global" për vitin 2021
4. Propozimin për zgjedhjen e Audituesit të jashtëm të Shoqërisë për vitin 2022
5. Propozimin për zgjedhjen e Audituesit të jashtëm të Fondit "WVP Top Invest" për vitin 2022
6. Propozimin për zgjedhjen e Audituesit të jashtëm të Fondit "WVP Global" për vitin 2022
7. Të ndryshme

Lidhur me pikën e parë, të dytë dhe të tretë të rendit të ditës bashkëlidhur këtij njoftimi keni dokumentacionin e nevojshëm. Në lidhje me pikat e rendit të ditës lutemi që nëse aksionarët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, mendojnë se ka diçka për të diskutuar ose kanë ndonjë propozim tjetër, të paraqesin mendimin e tyre në adresë të administratorit (kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike), si dhe dokumentacionin përkatës që mendon se është i nevojshëm t'u shpërndahet aksionarëve paraprakisht, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e mbledhjes.

Ju sjell në vëmendje se për të marrë pjesë në mbledhjen e asamblesë së aksionarëve, aksionarët duhet të paraqiten në ditën dhe orën e përcaktuar më sipër, në lidhje skype. Aksionarët mund të paraqiten dhe të marrin pjesë personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar. Si përfaqësues i aksionarit mund të jetë një aksionar tjetër apo një person i tretë. Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

Njoftimin e mbledhjes dhe dokumentacionin përkatës mund ta gjeni edhe në faqen web të shoqërisë në adresën në internet www.wvpfunds.al

Zotërimi i aksioneve aktualisht në shoqëri është si vijon:

- WVP Fund Management AD Shkup, person juridik i themeluar dhe regjistruar në shtetin maqedonas, me nr të regjistrimit tregtar 6938120, me seli ne Vasil Glavinov, nr.14-1/8 Shkup Qendër, zotëron [51%] ([pesëdhjetë e një përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 6,630 aksione.
- WVP-Ndërmjetësim në Sigurime sh.a Tirana, person juridik i themeluar dhe regjistruar në shtetin shqiptar, me nr të regjistrimit tregtar K62324003M, me seli Rruga Barrikadave, Ndertesa 18 H.6 Ap.11,Tiranë, zotëron [25%] ([njëzet e pesë përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 3,250 aksione.
- Z. Arton Lena zotëron [12.31%] ([dymbëdhjetë pikë tridhjetë e një përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 1,600 aksione.
- Z. Rupert Strobl zotëron [4%] ([katër përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 520 aksione.
- Z. Kujtim Ibraimi zotëron [4.69%] ([katër pikë gjashtëdhjetë e nëntë përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 610 aksione.
- Z. Ardian Kelmendi zotëron [2.5%] ([dy pikë pesë përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 325 aksione.
- Znj.Vjollca Mirashi zotëron [0.5%] ([zero pikë pesë përqind]) të aksioneve të kapitali të shoqërisë, ose 65 aksione.

Numri i votave në asamblenë e aksionarëve, që ka secili aksionar është i barabartë me numrin e akioneve që zotëron secili prej tyre.

Për sa më sipër, lutemi që çdo kërkesë të paraqitet në adresë të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë z. Arton Lena, në selinë e shoqërisë.

Lutemi konfirmoni marrjen e njoftimit për zhvillimin e mbledhjes së asamblesë.

Administrator
Arton Lena

